

|  |                                     |
|--|-------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO                                 |                                     |
| AGJENCIA QENDRORE E KOMBËTARË PËR KUNDËRVAJTJE<br>ANTI-KORRUPSION AGENCY |                                     |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.   | Nr. Prot.<br>Re. Prot.<br>Prot. No. |
| DPK/DMP  | 03-3044/12                          |
| Nr. flet.<br>Broj stranica   | Data<br>Datum                       |
| 01   | 29.08.2012                          |
| Nr. pages  | Re.I.nr.640/2012                    |

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, gjyqëtari Bekri Vehapi, në procedurën kundërvajtjese kundër të pandehurit Mehmet Hamza nga fshati Rapq komuna e Dragashit, për kundërvajtje sipas nenit 17 pika1,3 tI Ligjit 04/L-050 e në bazë të nenit 73,74 dhe 195 par.1 të Ligjit mbi kundërvajtjet /"Gazeta zyrtare e Kosovës",nr.23/79/, me datën 20.03.2012, merrë këtë.

## AKTVENDIM

PEZULLHET kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtjese e Agjencioni kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë nr.01-2150/2012. Kundër të pandehurit Mehmet Hamza.

Konform nenit 198 par.1 pika 8 të LMK-ës, si në arsyetim të këti aktvendimi.


## Arsyetim

Me kërkesen e Agjencionit kundër korrupsionit të Kosovës në Prishtinë Gjyqëtari me konkluzion e ka filluar procedurën kundër të pandehurit Mehmet Hamza nga fshati Rapq, komuna e Dragashit, shef i zyrës lokale të komunitetit në KK Dragash.

Gjykata ka marrë në shqyrtim shkresat e lëndës së Agjencionit, deklaraten e të pandehurit, dëshmit e prezentuara dhe duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit 04/L-050, pozita e Shefit të zyrës lokale të komunitetit sipas nenit 3 të Ligjit nuk është i përfshirë si zyrtar i lartë publikë që ka për obligim deklarimin e pasurisë, meqerast nuk mund të aplikohet dispozita ndeshkuese e nenit 17.pika1 dhe 3 të të njejtit ligj.

Më sa u tha më lartë është vendos si në dispozitiv.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DRAGASH, Me datën 23.08.2012,Re.I.nr.640/2012**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi parashihet si i kërkeses dhe i pandehuri kanë të drejten e ankimit në Gjykatën e lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të këti aktvendimi. Ankesa dërgohet me shkrim me dy egzenpilar përmesë Gjykatës komunale për kundërvajtje në Dragash.